



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 21 tetor 2019

Nr.re.:RK 1451/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI 69/18

Parashtrues

N.T.SH „Dilloni Benz“

**Kërkesë për vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës PN-II-10/2017 të 13 tetorit 2017**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga N.T.SH. „Dilloni Benz“ me seli në fshatin Miradi e Epërme, komuna e Fushë-Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës) të cilën e përfaqëson personi përgjegjës Fadil Berjani nga Fushë-Kosova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës PN-II-10/2017 të 13 tetorit 2017.
3. Aktvendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 23 tetor 2017.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenet 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Më 31 maj 2018, Gjykata miratoi në seancë administrative plotësimndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës Gjykata i referohet dispozitave juridike të Rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 11 maj 2018, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 18 maj 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.
9. Më 30 maj 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
10. Më 16 qershor 2018, përfundoi mandati i gjyqtarëve Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, përfundoi mandati i gjyqtarëve Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.
11. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

12. Më 29 nëntor 2018, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që ta plotësojë kërkesën dhe të paraqet formularin e plotësuar të kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo që të dorëzojë në Gjykatë një kopje të vërtetimit të pranimit të Aktgjykimit nr. 342/2017 të Gjykatës së Apelit nga ana e parashtruesit të kërkesës.
13. Më 7 dhjetor 2018, Gjykata Themelore e dorëzoi dokumentin e kërkuar.
14. Më 13 dhjetor 2018, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi në Gjykatë formularin e plotësuar të kërkesës.
15. Më 17 dhjetor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi kolegjin e ri shqyrtues në përbërje: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese) dhe Radomir Laban e Remzije Istrefi-Peci.
16. Më 18 dhjetor 2018, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore që t'i dorëzojë Gjykatës një kopje të vërtetimit për pranimin e Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PN-II-10/2017 nga ana e parashtruesit të kërkesës.
17. Më 20 dhjetor 2018, Gjykata Themelore e dorëzoi dokumentin e kërkuar.
18. Më 25 shtator 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

19. Më 18 korrik 2016, Inspektorati i Tregut i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (në tekstin e mëtejshëm: Shërbimi Kompetent i Inspektimit) bëri analizën e derivateve të naftës të ofruara në objektet e parashtruesit të kërkesës. Pas analizës së mostrave, u konstatua se derivatet e naftës në ofertë nuk janë në nivel me standardet e përshkruara.
20. Më 1 gusht 2016, shërbimi kompetent i inspektimit dorëzoi në Departamentin për Kundërvajtje të Gjykatës Themelore në Prishtinë kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje ndaj parashtruesit të kërkesës, për shkak të cilësisë së parregullt të derivateve të naftës të ofruara.
21. Më 20 mars 2017, Departamenti për Kundërvajtje i Gjykatës Themelore në Prishtinë nxori Aktgjykimin Nr. reg. 47453/16, me të cilin parashtruesi u shpall përgjegjës për kundërvajtje në lidhje me cilësinë e parregullt të derivateve të naftës në ofertë dhe, rrjedhimisht, iu shqiptua një gjobë.
22. Më 31 mars 2017, parashtruesi i kërkesës ndaj aktgjykimit të Departamentit për Kundërvajtje të Gjykatës Themelore në Prishtinë të 20 marsit 2017, parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit, *“ngase aktgjykimi është përfshirë me shkelje thelbësore të rregullave të procedurës dhe shkeljet materiale që janë bazë për anulimin e aktgjykimit.”*

23. Më 5 maj 2017, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin Ka. nr. 342/2017 hodhi poshtë, si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi në tërësi aktgjykimin e Gjykatës Themelore.
24. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës, parashtroi kërkesë në Departamentin për Kundërvajtje të Gjykatës Themelore në Prishtinë për përsëritje të procedurës në lëndën Nr. reg. 47453/16.
25. Më 4 korrik 2017, Departamenti për Kundërvajtje i Gjykatës Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin nr. 47453/16 refuzoi kërkesën e parashtruesit për përsëritje të procedurës për kundërvajtje.
26. Më 30 korrik 2017, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Departamentit për Kundërvajtje të Gjykatës Themelore në Prishtinë të 4 korrikut 2017.
27. Më 15 gusht 2017, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin Ka. nr. 589/2017 e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi në tërësi aktgjykimin e Gjykatës Themelore.
28. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, *“për shkak të shkeljes thelbësore të rregullave të procedurës (error in procedendo) dhe aplikimit të gabuar të ligjit -të së drejtës materiale (error in iudicando), me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës me aprovimin e revizionit ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë ose të anulojë të dy aktgjykimet dhe çështjen ta kthejë në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë mirëpo çështja të shqyrtohet nga një gjyqtarë tjetër.”*
29. Më 13 tetor 2017, Gjykata Supreme me Aktvendimin PN – II – 10/2017 e hodhi poshtë si të palejuar revizionin e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin:

“Konform dispozitave të Ligji Nr. 05/L-087 Për Kundërvajtje i cili ligj ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2017, në Kapitullin XXVI (nenet 146-149) si mjete të jashtëzakonshme juridike parashihen përsëritja e procedurës dhe kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.

I pandehuri e ka shfrytëzuar të drejtën e tij ligjore kur ka ushtruar kërkesën për përsëritje të procedurës (dhe instancat gjyqësore kanë vendosur për këtë kërkesë). I pandehuri pas shfrytëzimit të këtij mjeti të jashtëzakonshëm juridik ka ushtruar revizion, i cili konform ligjit dhe dispozitave ligjore (të cituara me lartë) nuk parashihet fare në ligjin për kundërvajtje.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

30. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të drejtës për mjete juridike.
31. Për më tepër, parashtruesi pretendon se: *“vendimi (aktgjykimi e aktvendimet) i gjykatave të trija shkallëve përmbajnë shkelje të kushtetutshmërisë [...], sepse gjatë gjithë gjykimet që nga procedimi e deri në fund gjykatat kanë*

përkrahur institucionin shtetëror -Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe NSH "Euro-Inspekt", duke ia falur besimin verbërisht raporteve të tyre të inspektimit dhe duke mos i marr parasysh fare pretendimet ankimore e provat e sjella nga parashtruesi, dhe kështu njëanshëm në mënyrë të vazhdueshme e njëtrajtshëm kanë vendosur në vendimet e njëra-tjetrës duke mos i heq asnjë presje brendisë së tyre."

32. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës konsideron që *"parashtruesi në rastin konkret ka paraqitur revizion, që shkalla e tretë e ka cilësuar si të palejuar, e që potencialisht, edhe po të mos jetë i lejuar, është dashtë që parashtruesin si laik i ligjit ta njoftoj për të drejtën e tij në mjete juridike, gjegjësisht si të veprojnë e çka të ndërmerr tutje."*
33. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata, *"SHFUQIZIMIN si të papajtueshëm me nenet 31 dhe 32 me Kushtetutën e Republikës së Kosovës të aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PN – II – 10/2017, dt 13.10.2017, aktgjykimin të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ka. nr. 342/2017, dt. 05.05.2017 dhe aktgjykimin të GJTHP-së nr. regj. 47453/16, dt. 20.03.2017."*

Pranueshmëria e kërkesës

34. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
35. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

Neni 21

"[...]"

*4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.
[...]."*

Neni 113

„(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]"

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

36. Gjykata më tej i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

37. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht aktvendimin PN–II–10/ 2017 të Gjykatës Supreme. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka deklaruar të drejtat dhe liritë të cilat pretendon se janë shkelur, në përputhje me kërkesat e nenit 48 të Ligjit.

38. Megjithatë, Gjykata i referohet edhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili parasheh:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]”

39. Gjykata merr parasysh edhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

“[...]”

(c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit [...].”

40. Gjykata vëren se aktvendimi i kontestuar (Aktvendimi PN–II–10/2017) i Gjykatës Supreme i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 23 tetor 2017, ndërsa kërkesa kushtetuese është dorëzuar më 11 maj 2018.
41. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se kërkesa kushtetuese është dorëzuar jashtë afatit ligjor 4 (katër) muajsh të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe specifikuar më tej me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës.
42. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar se rastet që kanë të bëjnë me çështje të Kushtetutës të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme, dhe se vendimet e mëparshme nuk janë vazhdimisht të hapura për t’u kontestuar (shih: rastin *Sabri Güneş kundër Turqisë*, kërkesa nr. 27396/06, Aktgjykim i 29 qershorit 2012, paragrafi 39, dhe *mutatis mutandis*, shih: rastin nr. KI140/13, parashtrues *Ramadan Cakiqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 marsit 2014).
43. Për sa më sipër, kërkesa nuk është dorëzuar në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës.

44. Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit është e pasafatshme dhe duhet të deklarohet e papranueshme, për shkak se nuk është dorëzuar në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, më 25 shtator 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Selvetë Gërxhaliu-Krasniqi


Arta Rama-Hajrizi

